Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0869

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vedat Poterqoi si Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani si anëtare, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Buqa" të datës 05.11.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 20.10.2023 të Autoritetit Kontraktues - Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pjesë për automjetet Skoda Rapid" me numër të prokurimit 214-23-1137-1-1-1 në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 28.12.2023 merr këtë:

Vendim

1. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa e operatorit ekonomik "Buqa" me nr. 2023/0869e datës 05.11.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 20.10.2023të Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pjesë për automjetet Skoda Rapid" me numër të prokurimit 214-23-1137-1-1-1.

2. **Mbetet në fuqi,** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 20.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP, konfiskohen mjetet e depozituara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.03.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pjesë për automjetet Skoda Rapid" me numër të prokurimit 214-23-1137-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratëspër furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 550,000.00€.

Me datë 20.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik "Ideal Shala" B.I.

Me datë 25.10.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 27.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik ankues.

Me datë 05.11.2023 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0869.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Pretendimet kryesore të operatorit ekonomik ankues të cilat janë klasifikuar si të tilla edhe sipas raportit të ekspertit shqyrtues janë si në vijim:

> **Pretendimi i parë (I) -** "*Kur analizohet dokumentacioni i OE të rekomanduar për kontratë, të cilat i ka prezantuar me ofertë shihet se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e AK pasi që në listën e kontratave ka prezantuar kontrata që nuk janë të njëjta apo te ngjashme me qëllimin e vet aktivitetit te prokurimit qe ka beje vetme me pjese rezerve për automjete, në listën e kontratave te prezantuar nga OE i rekomanduar ka kontrata dhe referenca që nuk janë te natyrës se njejt apo te ngjashme me këtë tender*".

> **Pretendimi i dytë (II) -***"OE i rekomanduar për kontratë e ka dërguar një autorizim nga një distributor INTER CARS i cili nuk dihet se a është i autorizuar duke e pasur parasysh psh, Firma Mercedes-Benz, VW Grup nuk lëshojn autorizime për pjeset e veta e qe i ka cekur aty".*

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 51, 59, 60, 72 dhe 99.2 të LPP.Operatori

ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që të kthehet lënda në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10.11.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 17.11.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim duke vënë theks te veçantë mbi llogaritjen apo jo të kontrates diskutabile mbi mungesen e referencës dhe dates se përfundimit te saj*".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Eksperti i ka shkruar Autoritetit Kontraktues duke bere te çartë se mungon referenca apo pranimi teknik i kontrate kornizë (me titull Furnizim me pjesë rezerve dhe mirëmbajtja e makinerisë së rëndë - buldozerëve) dhe se ka kerkuar sqarime se si eshte vleresuar apo llogaritur kjo kontrate kornize dhe si eshte marre parasysh duke pare qe nuk ka reference zyrtare apo edhe pranim teknik zyrtar pervec emailit te l artecekur (ku AK shkruan me fjalë se kjo kontratë ka shkuar gjithçka ne rregull), por qe eksperti nuk ka ne dispozicion nje date te perfundimit te kesaj kontrate. Eksperti konsideron qe duke pare per baze kete kerkese te dosjes dhe fakteve te pranuara nga eksperti dhe informatave shtese te marra konsider oj me qe nuk ka fakte te mjaftueshme dhe eksperti nuk eshte ne gjendje qe kjo kontrate te mirret per baze si kontrate e perfunduar pasi qe i mungon referenca perfundimtare mbi perfundimin e saj dhe se eksperti me kete rast nuk eshte ne gjendje te precizoje sakte se kur ka perfunduar kjo kontrate ne menyre qe te beje llogaritjen nese kjo kontrate eshte e barazvlefshme me kushtet e kerkuara ne DT per 3 vitet e fundit nga data e njoftimit te kesaj kontrate. Andaj, porpozon qe AK gjate rivleresimit te kesaj lende ta shqyrtoje kete pozicion dhe kete kontrate edhe njehere dhe ta sqaron si duhet daten e permbylljes te kesaj kontrate.*

Po te shohim edhe kontraten e lidhur ne vitin 2017 ë rezervë dhe servisimi i tyre për bulldozhera të KMDK), as

aty nuk ka ndonje datë të perfundimit por vetem ajo e nenshkrimit te saj qe eshte 30.01.2017 e qe nese bazohemi ne daten e njoftimit te kontrates se Dosjes se tenderit e cila eshte 02.03.2023, i bi e qe nese do te kishte perfunduar per 3 vite nga data e nenshkrimit do duhej te jete 30.01.2020. Gjithashtu , OE ankues atakon vendimin e AK duke pretenduar qe brenda kesaj kontrate ka fatura te cilat nuk perkojne me lemin e kontratave te kerkuara te ngjashme me furnizim me pjese rezerve se dhe brenda saj ka edhe fatura per saldim, bateria, gypa hidraulike, riparime te gypave etj, gje qe eshte e vertetë qe ne dosjet e derguara te disa faturave emertime te tilla ekzistojne dhe per kete arsye edhe PSH ne vendimin e marre per kete çeshtje ka parashtruar komentet e tyre drejtuar AK qe gjate rivleresimit ta shqyrtoje kete teme diskutabile mbi furnizime dhe sherbimet e ketij lloji".

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor, eksperti shqyrtues ka paraqitur në raportin e tij konstatimet si në vijim: "*Eksperti ka marre informata shtese nga AK ku vertetohet autorizimi me shkrim nga kompania INTERCARS e cila konfirmon per vertetesine e autorizimeve ne fjale dhe qe dokumentet e dorezuara nga OE Ideal Shala jane te nenshkruara dhe vulosura nga ana e kompanise ne fjale. Andaj, duke konsideruar kete fakt eksperti shqyrtues konsideron qe ky pretendim eshte i pabazuar dhe se pretendimet lidhur me dyshimet e OE ankues per manipulimet me autorizimet nuk mund te mirren parasysh nga eksperti ne mungese te fakteve tjera dhe mbeten vetem supozime te tilla*".

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues. Argumentimi i ekspertit shqyrtues është i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se operatori ekonomik ankues "Buqa" ka parashtruar edhe më herët ankesë (konkretisht me datë 09.06.2023 me Nr. të prot. 2023/0377) lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht me datë 09.10.2023 Paneli Shqyrtues në OSHP kishte marrë vendimin me nr. 2023/0377 përmes të cilit e kishte miratuar si pjesërisht të bazuar ankesën ashtu që e kishte kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit së bashku me udhëzimet konkrete për autoritetin kontraktues.

Me rastin e analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit, Paneli Shqyrtues ka gjetur se kjo lëndë është trajtuar edhe më herët në OSHP sipas vendimit 2023/0377 të datës 09.10.2023. Prandaj për Panelin Shqyrtues kjo është çështje e gjykuar (res judicata) në kuptim të nenit 5, paragrafi 2.16 të LPP, si dhe nenit 23 paragrafit 11 të Rregullores së Punës në OSHP.

Në vendimin e lartëcekur aktiviteti i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim vetëm për faktin se, citat vendimi i OSHP Nr. 2023/0377. "Andaj përfundimisht lidhur me këtë çështje është arritur në vendimin përfundimtar siç i shtjellua si më sipër, që rrjedhimisht ka rezultuar që nga ana e panelit u konsiderua se aktiviteti duhet të kthehet në rivlerësim si dhe rivlerësimi të bëhet duke vlerësuar kontratat si kontrata të plota dhe jo të ndara, duke pranuar apo mos pranuar të njëjtat në tërësi bazuar në kërkesën e DT dhe legjislacionit në fuqi, e poashtu në rast të mungesës së informacionit lidhur me përfundimin, referencën dhe informacionet tjera të aplikojë dispozitat rregulluese të neneve 72 dhe 59 të LPP-së". Pra, aktiviteti i prokurimit është kthyer në ri-vlerësim vetëm për faktin se AK nuk i ka marrur në konsideratë kontratat si të plota por në vlerësimin e parë të ofertave ka bërë ndarje të kontratave, veprim ky i cili ka qenë në kundërshtim me interpretimin ligjor nga KRPP, konkretisht pyetja nr 10 "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet? , ndërsa në përgjigjje ndër të tjera theksohet se: *Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet.* Kështu që ka mbet në diskrecion të AK të vendos lidhur me këtë çështje për shkak se është evidente se ashtu siç është konstatuar në vendimin paraprak citat: "Kontrata "Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e makinerisë se rëndë (buldozerëve) me nr. KMDK-19-4022-1-1-1 ne vlere 394,361.81 €,e cila mund të konsiderohet si kontrata kryesore në listën e dorëzuar për shkak të vlerës së saj në raport me kontratat tjera, që në rast mos konsiderimi të kësaj kontrate nga ana e AK-së OE i rekomanduar do të mund të cilësohej si OE i papërgjegjshëm, lidhur me rrjedhën e rrethanave të zhvilluara në raport me vlerësimin e ofertave nga ana e AK-së lidhur me kontratën e njëjtë është evidentuar se AK ka kërkuar sqarime nga ana e OE të rekomanduar lidhur me referencën, poashtu lidhur me përfundimin e së njëjtës me ç 'rast OE ankues ka paraqitur faturat e shitjes mbi shërbimet dhe furnizimet e kësaj kontrate po ashtu një komunikim nga AK i asaj kontrate që e "njëjta ka përfunduar në rregull".

Sa i përket pretendimit të dytë ankimor, nga dëshmitë e siguruara nga eksperti shqyrtues është gjetur se operatori ekonomik ankues nuk ka arritur që parashtroj argumente bindëse sipas të cilave do të mund të vërtetohej se autorizimi i dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar nuk është autorizim me përmbajtje të saktë sikurse pretendohet me ankesë. Prandaj Paneli Shqyrtues konsideron ky pretendim ankimor është i pabazuar dhe pajtohet plotësisht me konstatimin e ekspertit shqyrtues ku thuhet se "*pretendimet lidhur me dyshimet për manipulimet me autorizimet nuk mund të mirren parasysh nga eksperti në mungesë të fakteve tjera dhe mbeten vetëm supozime të tilla".* Por si do që të jetë autoriteti kontraktues konform nenit 52.7 të LPP, nëse e sheh të arsyeshme dhe dyshuese mund ta ushtrojë një kontroll efektiv. Por edhe palët tjera mund të ju drejtohen organeve kompetente.

Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që

duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".
Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, dhe të prolongimi deri në pafundësi të aktivitetit të prokurimit, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".
Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur ne konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim me të lirë në raport me ofertën e ankuesit.
Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Dyqani i Pavarur Tregtar Autopjesë " Buqa "**
- Arkivës së OSHP-së: